


Tregtia e jashtme e mallrave

Korrik 2016

Tiranë, më 29 Gusht 2016: Në muajin Korrik 2016 eksportet e mallrave arritën vlerën 22 mld lekë, duke u ulur me 0,6 % në krahasim me Korrik 2015 dhe me 0,9 % në krahasim me Qershor 2016. Importet e mallrave në muajin Korrik 2016 arritën vlerën 50 mld lekë, duke u ulur me 5,0 % në krahasim me Korrik 2015 dhe me 4,3 % në krahasim me Qershor 2016. Deficiti tregtar i këtij muaji është 27 mld lekë, duke u ulur me 8,3 % krahasuar me Korrik 2015 dhe me 6,9 % në krahasim me Qershor 2016.


Fig. 1 Qarkullimi i mallrave, Qershor 2015 – Korrik 2016 (miliardë lekë)



Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rënia vjetore e eksporteve prej 0,6 % këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -5,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,9 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -0,6 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Tekstile dhe këpucë” me +6,1 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” kanë kontribuar me +0,5 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +0,2 pikë përqindje.


Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve



Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rënia vjetore e importeve prej 5,0 % këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -4,8 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -2,9 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,03 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Tekstile dhe këpucë” me +1,0 pikë përqindje”, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,9 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +0,7 pikë përqindje.


Fig.3 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve



Në muajin Korrik 2016, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Korrik 2015 janë: Italia me 1,9 %, Greqia me 23,9 % dhe Kina me 36,6 %. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Malta me 11,3 %, Kosova me 20,3 % dhe Gjermania me 5,3 %.

Në muajin Korrik 2016, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Korrik 2015 janë: Greqia me 18,3 %, Kina me 10,4 % dhe Gjermania me 1,1 %. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia me 6,9 %, Turqia me 17,1 % dhe Serbia me 24,5 %.

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Korrik 2016



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 70,5 % të gjithë tregtisë. Në Korrik 2016, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 80,7 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 65,9 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (37,8 %), Greqia (7,3 %), Kina (6,5 %) dhe Gjermania (6,1 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave (milionë lekë)

Vitet	Muajt	Eksporte	Importe	Bilanci Tregtar	% e mbulimit
2000		37.037	157.109	-120.072	23,6
2001		44.096	190.155	-146.059	23,2
2002		47.490	210.368	-162.878	22,6
2003		54.487	225.983	-171.496	24,1
2004		62.121	236.072	-173.951	26,3
2005		65.818	262.191	-196.373	25,1
2006		77.405	299.147	-221.742	25,9
2007		97.171	376.194	-279.023	25,8
2008		112.572	439.894	-327.322	25,6
2009		104.515	428.839	-324.324	24,4
2010		161.548	477.768	-316.220	33,8
2011		196.897	544.004	-347.107	36,2
2012		213.030	528.490	-315.460	40,3
2013		246.397	517.378	-270.981	47,6
2014		255.759	552.281	-296.522	46,3
2015		243.183	544.606	-301.423	44,7
2014	01 - 14	17.869	34.922	-17.053	51,2
	02 - 14	20.304	39.193	-18.889	51,8
	03 - 14	21.302	42.478	-21.176	50,1
	04 - 14	22.720	44.308	-21.588	51,3
	05 - 14	25.317	48.241	-22.924	52,5
	06 - 14	22.490	49.351	-26.860	45,6
	07 - 14	22.911	47.158	-24.247	48,6
	08 - 14	18.582	44.601	-26.019	41,7
	09 - 14	21.324	47.404	-26.080	45,0
	10 - 14	22.269	52.436	-30.167	42,5
	11 - 14	21.380	48.080	-26.700	44,5
	12 - 14	19.290	54.108	-34.818	35,7
2015	01 - 15	17.763	35.245	-17.482	50,4
	02 - 15	18.392	38.889	-20.497	47,3
	03 - 15	22.179	44.437	-22.258	49,9
	04 - 15	20.783	43.696	-22.913	47,6
	05 - 15	24.098	44.382	-20.284	54,3
	06 - 15	24.158	48.956	-24.798	49,3
	07 - 15	22.540	52.411	-29.871	43,0
	08 - 15	15.376	40.126	-24.750	38,3
	09 - 15	20.403	44.027	-23.624	46,3
	10 - 15	20.204	50.249	-30.044	40,2
	11 - 15	19.468	49.017	-29.549	39,7
	12 - 15	17.817	53.170	-35.353	33,5
2016	01 - 16	16.380	34.879	-18.499	47,0
	02 - 16	17.592	41.841	-24.249	42,0
	03 - 16	19.361	46.938	-27.577	41,2
	04 - 16	21.129	51.979	-30.850	40,6
	05 - 16	20.526	51.803	-31.277	39,6
	06 - 16	22.603	52.001	-29.397	43,5
	07 - 16	22.400	49.780	-27.380	45,0

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Kor-15	Kor-16	Jan.- Kor 2015	Jan.- Kor 2016	Kor-15	Kor-16	Jan.- Kor 2015	Jan.- Kor 2016
Vendet e BE-së	17.852	18.086	108.570	112.036	33.849	32.827	192.327	209.888
Austri	105	72	2.201	655	743	516	3.737	3.337
Mbretëri e Bashkuar	55	61	331	287	354	371	2.615	2.427
Gjermani	798	756	4.335	4.631	3.598	3.637	20.258	31.255
Greqi	771	955	5.528	6.562	3.650	4.317	25.835	25.994
Itali	11.578	11.793	72.343	80.116	16.637	15.481	95.605	99.618
Spanjë	1.064	462	7.205	2.895	1.095	1.052	4.830	7.155
Kroaci	59	62	279	694	1.737	526	4.075	2.463
Të tjera të BE-së	3.423	3.925	16.348	16.196	6.035	6.926	35.371	37.639
Kinë	524	716	4.355	3.118	3.613	3.986	25.341	29.278
Kosovë	1.733	1.382	13.689	9.241	553	492	3.338	3.123
Maqedonia	616	534	3.890	3.320	750	687	4.612	4.078
Rusi	-	-	25	46	1.036	801	5.882	6.556
SHBA	131	177	1.588	880	858	993	5.885	6.255
Turqi	747	175	6.085	904	3.878	3.214	23.273	24.844
Ukrainë	5	24	78	117	468	195	2.117	2.063
Zvicër	86	124	2.009	1.443	527	464	4.520	4.160
Të tjera	845	1.182	9.625	8.885	6.878	6.120	40.721	38.974
Gjithsej	22.540	22.400	149.914	139.990	52.411	49.780	308.016	329.219

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Kor-15	Kor-16	Jan.- Kor 2015	Jan.- Kor 2016	Kor-15	Kor-16	Jan.- Kor 2015	Jan.- Kor 2016
Gjithsej	22.540	22.400	149.914	139.990	52.411	49.780	308.016	329.219
Ushqime, piqe, duhan	1.835	1.786	11.127	13.810	9.124	9.492	54.833	57.181
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	5.690	4.390	42.933	24.993	5.488	3.949	33.380	27.002
Produkte kimike dhe plastike	321	372	2.376	2.469	7.228	7.236	44.454	46.373
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	312	229	1.750	1.706	1.655	1.640	9.628	10.607
Prodhime druri dhe letre	716	591	4.756	4.413	1.987	2.129	12.085	13.030
Tekstile dhe këpucë	9.170	10.547	52.903	64.204	6.305	6.810	38.724	46.210
Materiale ndërtimi dhe metale	3.030	2.829	23.165	17.693	7.458	4.939	39.778	44.404
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	833	955	7.222	6.561	11.264	11.738	63.659	72.379
Të tjera	633	701	3.683	4.143	1.902	1.847	11.475	12.034

Tab. 4 Eksportet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, (Jan. – Kor. 2015 , Jan. – Kor. 2016)

(milionë lekë)

	Itali		Kosovë		Greqi		Gjermani	
	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016
Gjithsej	72.343	80.116	13.689	9.241	5.528	6.562	4.335	4.631
Ushqim, pije duhan	3.308	3.939	1.424	1.653	1.074	1.297	602	605
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	6.317	5.338	6.487	1.874	477	276	19	109
Produkte kimike dhe plastike	732	799	681	747	192	226	3	158
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.523	1.546	-	0	16	29	3	3
Prodhime druri dhe letre	3.703	3.290	165	172	397	538	59	56
Tekstile dhe këpucë	43.439	51.467	47	45	2.344	2.848	2.888	3.067
Materiale ndërtimi dhe metale	8.068	7.521	3.915	3.630	808	1.081	396	259
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	3.637	4.443	282	374	47	36	239	252
Të tjera	1.617	1.774	689	744	173	230	126	120

Tab. 5 Importet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, (Jan. – Kor. 2015 , Jan. – Kor. 2016)

(milionë lekë)

	Itali		Gjermani		Kinë		Greqi	
	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016
Gjithsej	95.605	99.618	20.258	31.255	25.341	29.278	25.835	25.994
Ushqim, pije duhan	9.993	10.019	2.163	2.523	319	276	7.674	8.466
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	14.708	11.380	299	307	34	715	4.686	2.816
Produkte kimike dhe plastike	8.600	9.789	4.209	3.748	2.250	2.532	4.171	4.591
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	7.597	8.327	47	2	422	422	50	90
Prodhime druri dhe letre	4.249	3.684	506	492	438	560	1.313	1.532
Tekstile dhe këpucë	20.665	24.121	1.429	1.551	4.376	5.369	1.759	2.175
Materiale ndërtimi dhe metale	11.111	9.943	614	8.925	4.933	5.778	3.756	3.824
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	15.693	18.915	10.174	12.758	10.385	11.267	1.614	1.616
Të tjera	2.991	3.439	816	948	2.183	2.358	811	885

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

÷ deri